



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2751/5 prot.

Datë 22/11/2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1212/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22/11/2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. REF-83568-10-12-2023, me objekt: “*Blerje ECHO KARDIAKE*”, me fond limit 2.500.2000 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK me NIPT: J61817047D, dhe me adresë: *Bulevardi “Zhan D'ark”, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat  
Adresa: *Lagjja “Drita”, KP 8001, Burrel.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.10.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. REF-83568-10-12-2023, me objekt: “*Blerje ECHO KARDIAKE*”, me fond limit 2.500.2000 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

II.2. Më datë 23.10.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 31.10.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “MONTAL” shpk	1.875.800 leke	skualifikuar
2. “BNT ELECTRONIS” shpk	1.926.595 leke	skualifikuar
3. “MEDFAU” shpk	1.900.000 leke	skualifikuar
4. “TRIMED” shpk	2.150.000 leke	kualifikuar
5. “MSE” shpk	2.480.000 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 31.10.2023, operatori ekonomik “BNT ELECTRONIS” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

*“Oferta juaj eshte refuzuar.*

*arsye:*

- *Mungon tastiera me ndricim interaktiv.*
- *thellesia e skanimit te sodnes mungon.*
- *Modalitetet e skanimit 2b, 4b, b/bc mungojne.*
- *Ne modalitetin PË mungon parametri i autokalkulimit.*
- *Formati i imazhit 1:1, 2:2 mungon.*
- *Nuk ka te dhena mbi frame rate te Bmode apo Cmode.”.*

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 02.11.2023 autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “*TRIMED*” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 08.11.2023, operatori ekonomik ankimues “*BNT ELECTRONIS*” SHPK ka paraqitur ankesë, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2751/2 prot, datë 09.11.2023.

II.8. Me shkresën dërguar me anë të sistemit elektronik të ankesave nr. 1229 prot, datë 14.11.2023 me objekt: “*Dërgojmë vendimin për trajtimin e ankesës*”, protokolluar me tonën me nr. 2751/3 prot datë 14.11.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*BNT ELECTRONIS*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.9. Me shkresën nr. 1229 prot, datë 14.11.2023 me objekt: “*Dërgojmë vendimin për trajtimin e ankesës*”, protokolluar me tonën me nr. 2751/4 prot datë 16.11.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik më mënyrë shkresore, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*BNT ELECTRONIS*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës, ku ndër të tjera ka argumentuar se: “*...Pretendimi i OE “BNT ELECTRONICS” për paraqitjen e katalogut të markuar me të gjithë parametrat teknike të kërkuar nuk qëndron. Pas një kontrolli në detaje të katalogut në tërësi dhe jo vetëm pjesës së markuar, konstatoam se parametrat si vijojnë, mungojnë:*

- *Modalitetet e skanimit: B, 2B, 4B, B/BC, Chroma B&M&PË, InstantTriplex. Chroma B&M&PË nuk ekuivalentohen me hartën e ngjyrimit chroma sikundër del nga*

*katalogu i Operatorit Ekonomik. Chroma B&M&PË është modalitet skanimi i trefishtë dhe jo hartë ngjyrimi.*

- *Në modalitetin B kërkohet mundësia selektimi për të paktën 5 shkallë frekuence dhe gjerësia e skanimit të ketë mundësi selektimi për minimumi 6 shkallë. Nuk ka asnjë të dhënë në rast se ky modalitet sigurohet nga pajisja apo jo.*
- *Nuk suportohet formati i imazhit 1:1, 2:2.*
- *Në modalitetin PË kërkohet të suportojë modaliteti i operimit triplex dhe quadraplex. Sikundër parashikohet në katalogun e Operatorit Ekonomik, ky opsion mund të sigurohet vetëm deri në duplex, dhe jo më tepër në modalitetin triplex dhe aq më pak në modalitetin quadplex.*
- *Në modalitetin CË nuk ka parashikime mbi Këndin e shpejtë dhe opsionin e shpejtësisë së segmenteve kardiake.*
- *Nuk ka parashikime mbi frame rate për modalitetin B prej jo më pak se 900 dhe modalitetin C prej jo më pak se 260. Në katalogun e operatorit ekonomik, mund të konstatohet vetëm ruajtja dhe shfaqja e deri në 30000 frames të modalitetit 2D Color dje PË/CË images. Ndër këto modalitete nuk konstatohet asnjë nga ato të kërkuara, dhe aq më pak disa nga modalitetet e ofruara nga vetë pajisja. Pra, kemi të bëjmë me përzgjedhje të imazheve të dala nga vetëm disa prej modaliteteve dhe jo prej të gjithave.*
- *Parashikimi se pajisja suporton thellësinë e skanimit të sondave deri në 40cm nuk mund të ekuivalentohet me thellësinë e skanimit të sondës kardiake të ofruar nga operatori ekonomik, për të cilën nuk kemi asnjë detaj të tillë.*

*Operatori Ekonomik ka synuar të sjellë në vëmendje të AK dhe KPP se katalogët janë dokumente standarte dhe nuk mund të përmbajnë dhe kritere teknike “periferike” të përshatshme sipas kërkesave të AK. Sikundër, mund të konkludohet nga analiza e mësipërme, modalitetet e skanimit, formati i imazhit apo thellësia e skanimit të sondave nuk mund të cilësohen si kritere periferike. Këto kanë të bëjnë me funksionalitetin në themel të pajisjes dhe jo thjesht përshkrime “periferike”. Në rastin e integritet të tyre në pajisje apo në rastin e përmirësimit të këtyre modaliteteve, kemi të bëjmë me një pajisje të re e cila ka nevojë gjithashtu për një vlerësim në themel nga Organet Ndërkombëtare për certifikimin CE. Siç oarashikohet në Dokumentat Standarte të Tenderit, certifikata CE është një dokument, mungesa e të cilit përbën shkak skualifikimi të operatorit ekonomik.*

*Lidhur me pretendimin se Operatori Ekonomik, në dokumentin “Deklaratë Mat” ka deklaruar se pajisja e ofruar prej ti plotëson të gjitha parametrat e parashikuar në DST, ky pretendim nuk qëndron pasi Operatori Ekonomik ka marrë përsipër të kryejë furnizimin apo lëvrimin e pajisjes sipa kërkesës së AK. Kjo kërkesë ka të bëjë me afatin brenda të cilit Autoriteti kontraktor ka kërkuar të pajiset me këtë artikull.*

*Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik ka arritur të plotësojë të gjitha specififikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentat e tenderit dhe kjo provohet përmes certifikatave dhe dokumentave të paraqitura me këtë deklaratë. Për sa më sipër, rezulton se deklarata e Operatorit Ekonomik dhe katalogu i markuar janë haptazi në kundërshtim me njëra-tjetrën, e provueshme lehtësisht nga kriteri i formatit të imazhit, kriter minimal i cili parashikohet në*

*çdo rast në mënyrë të detajuar nga çdo prodhues dhe nuk lihet në çmimin e blerësit apo distributorit për ta cilësuar përmes deklaratave.*

*Për sa argumentuam më sipër, pretendimi i OE nuk qëndron.”.*

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes ”BNT ELECTRONICS” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: “... Në përmbushje të kriterëve teknike për këtë pajisje, OE Bnt Electronics shpk ka ofertuar pajisjen model VINNO E35 + Printer. Në përputhje me kërkesën e Ak, ne kemi paraqitur Katalogun e markuar me të gjithë parametrat teknike të kërkuar.

Sjellim në vëmendje të AK dhe KPP se katalogët teknikë janë dokumenta standart, të përgatitur nga prodhues të ndryshëm në të cilat gjenden të pasqyruara karakteristikat më të rëndësishme dhe kryesore të pajisjeve. Disa kriterë teknike “periferike” cilat janë të përshatshme sipas kërkesave të AK nuk janë të përfshira në katalog. Këto janë kërkesa të cilat merren përsipër dhe garantohen të plotësohen nga Operatori Ekonomik. Për këtë arsye ne kemi deklaruar në shtojcën 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, kemi deklaruar në cilësinë e OE se plotësojmë të gjitha soecifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

Duke qenë se si më lartë, jo të gjithë parametrat teknike gjenden në katalog dhe me qellim për ti ardhur në ndihmë AK për të identifikuar sa më saktë dhe me të gjitha detajet teknike përkatëse, shoqëria jonë ka paraqitur në tender, dokumentin “Oferta Teknike” e cila pasqyron të gjitha parametrat teknike që ofron pajisja jonë, dhe konkretisht kemi dërguar këtë material....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”, të dokumenteve të tenderit të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.5 është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

2.3.1 “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtimin e pajisjeve mjekësore.”.

III.1.2. Në Shtojcën 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*”, të dokumenteve të tenderit të autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi, si më poshtë:

**“Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

➤ **Pajisja mjekësore (ECHO KARDIAKE) duhet të ketë specifikimet e mëposhtme:**

– Të jetë e përshtatshme për të gjitha ekzaminimet abdominale, gjinekologjike, obstetrike, vaskulare, kardiake, pediatrike, muskuloskeletale, urologjik, tiroide, gjiri etj.

– Të ketë ekran me ngjyra, me teknologji LED dhe rezolucion të lartë.

– Madhësia e ekranit diagonal të jetë, jo më pak se 21 inch.

– Kontrasti dhe ndriçimi të jenë të rregullueshëm.

– Të ketë panelin e komandimit ekran me prekje, min 10 inch, me rezolucion të lartë.

– Pajisur me të paktën 3 porta aktive për vendosjen e sondave.

– Të jetë e pajisur me ngrohës xheli.

– Çelësat e tastierës me ndriçim interaktiv.

– **Modalitetet e skanimit:**

*Modaliteti -B, 2B, 4B, B/M, B/BC, CFM, PË, Poëer Doppler/PD Directional, Instant Triplex, Duplex, Quadplex, Trapezoidal, Chroma B&M&PË, Full Screen.  
Modalitet i plotë 3D/4D.*

– **Modaliteti B**

*Të ketë mundësi selektimi për minimumi 5 shkallë frekuence.*

*Rrotullimi i imazhit 0°, 90°, 180°, 270°,*

*Gjerësia e skanimit të ketë mundësi selektimi për minimumi 6 shkallë*

– **Modaliteti PË**

*Modaliteti Doppler Spectral PË*

*Të ketë mundësi selektimi për minimumi 5 shkallë frekuence.*

*Triplex, Quatraplex, Invert, Auto Cal.*

*Parametër Auto Kalkulimi*

*Hart me ngjyra*

*Formati i imazhit: 1:2, 1:1, 2:2*

*Kënd të shpejtë jo më të vogël se ±60*

*Të jetë Frekuenca e përsëritjes së pulsit PRF për sondën kardiake jo më të vogël se 1-9 kHz*

– **Modaliteti CË**

*Constinuos ëave doppler i aplikueshëm me sondat kardiake*

*Të ketë mundësi selektimi për minimumi 5 shkallë frekuence*

*Formati i imazhit: 1:2, 1:1, 2:2*

*Kënd i shpejtë jo më të vogël se ±60*

*Doppler indor, imazh indor me ngjyra, matje shpejtësie e segmenteve kardiake, Kënd i shpejtë, Audio, Parete me filtra .*

*Të përfshihen paketat e mëposhtëme:*

*Paketa e plotë matjeve:*

*Abdominale, Gjinekologjike, Obstetrike, Vaskulare, Kardiake, Urologjike, Pediatrike, pjesët e vogla (Tiroide, etj).*

*Eko-ja duhet të jetë e pajisur me opsionin Elastografi*

– **Karakteristika të tjera:**

*Të ketë memorie të paktën 500 GB.*

*Funksion raportimi me mundësi integrimi të imazheve.*

*Ndërfaqje: USB, VGA, Ethernet, Audio, S-Video, DVI*

*Të suportojë softëare DICOM*

*Furnizimi me energji:*

*Automatikisht i adaptueshëm për AC100-240V*

*Frekuenca e furnizimit me energji elektrike: 50-60 Hz*

– **Sonda dhe aksesore të përfshirë:**

*1 (një) sondë kardiake, jo më e vogël se 1.5-5.3 MHz*

*Te kete Frekuenca e përsëritjes së pulsit PRF ne C Mode jo me te vogel se 1-7kHz*

*Frame rate B Mode: Jo më e vogël se 900, C Mode: Jo më e vogël se 260*

*Thellësia e skanimit të sondës deri ne 36 cm, Këndi: jo me te vogel se 80°.*

*Video printer bardh e zi.*

***Periudha e garancisë për pajisjen Eko e përgjithshme do të jetë 2 (dy) vite nga data e lëvrimit të mallit pranë autoritetit kontraktor.***

***Afati i levrimit: 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.***

**Shënim:**

*Në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik<sup>1</sup>”, sqarojmë operatorët ekonomik pjesëmarrës, se në rastet kur përmendet **çertifikatë, markë, emër i veçantë**, pranohet edhe **ekuivalent i tyre.**”*

III.1.3. Nga shqyrtimi i procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” konstatohet se hartimin dhe vendosjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit objekt ankimimi, si dhe hartimin dhe vendosjen e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të po këtyre dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor i ka argumentuar si në vijim:

**“Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, 2, 4 dhe nenit 79 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...”

**Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.**

**2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.**

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Neni 79 pika 1 i LPP-së, në të cilin përcaktohet se, citojmë: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:  
a) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose  
bc) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së produktit objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së mallit/ pajisjes që kërkohen të blihen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatën ISO 9001, me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.



2. Gjithashtu, njësia e prokurimit referuar specifikes që ka pajisja objekt prokurimi, e cila duhet të jetë e një cilësie të mirë, referuar kostos dhe funksionit që ka, me qëllim vërtetimin se ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës përmbushin specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do ta sigurojë këtë mallin/ pajisjen mjekësore objekt kontrate, katalogun e mallit/ pajisjes me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse malli/ pajisja për të cilën do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës është në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

*Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Bazuar në shkresën me Nr.Prot.953, datë 31.08.2023 “Relacion për përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike...” dërguar nga Komisioni për Përcaktimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike/ Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik<sup>1</sup>”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.*

- *Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.*
- *Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.”.*

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik “BNT ELECTRONICA” SHPK ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

*-Datashet\_2\_Vinno.pdf.*

III.1.5. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor argumenton se: “...Pretendimi i OE “BNT ELECTRONICS” për paraqitjen e katalogut të markuar me të gjithë parametrat teknike të kërkuar nuk qëndron. Pas një kontrolli në detaje të katalogut në tërësi dhe jo vetëm pjesës së markuar, konstatoam se parametrat si vijojnë, mungojnë:

- *Modalitetet e skanimit: B, 2B, 4B, B/BC, Chroma B&M&PË, InstantTriplex. Chroma B&M&PË nuk ekuivalentohen me hartën e ngjyrimit chroma sikundër del nga katalogu i Operatorit Ekonomik. Chroma B&M&PË është modalitet skanimi i trefishtë dhe jo hartë ngjyrimi.*
- *Në modalitetin B kërkohet mundësia selektimi për të paktën 5 shkallë frekuence dhe gjerësia e skanimit të ketë mundësi selektimi për minimumi 6 shkallë. Nuk ka asnjë të dhënë në rast se ky modalitet sigurohet nga pajisja apo jo.*
- *Nuk suportohet formati i imazhit 1:1, 2:2.*
- *Në modalitetin PË kërkohet të suportojë modaliteti i operimit triplex dhe quadraplex. Sikundër parashikohet në katalogun e Operatorit Ekonomik, ky opsion mund të sigurohet vetëm deri në duplex, dhe jo më tepër në modalitetin triplex dhe aq më pak në modalitetin quadplex.*
- *Në modalitetin CË nuk ka parashikime mbi Këndin e shpejtë dhe opsionin e shpejtësisë së segmenteve kardiake.*
- *Nuk ka parashikime mbi frame rate për modalitetin B prej jo më pak se 900 dhe modalitetin C prej jo më pak se 260. Në katalogun e operatorit ekonomik, mund të konstatohet vetëm ruajtja dhe shfaqja e deri në 30000 frames të modalitetit 2D Color dje PË/CË images. Ndër këto modalitete nuk konstatohet asnjë nga ato të kërkuara, dhe aq më pak disa nga modalitetet e ofruara nga vetë pajisja. Pra, kemi të bëjmë me përzgjedhje të imazheve të dala nga vetëm disa prej modaliteteve dhe jo prej të gjithave.*
- *Parashikimi se pajisja suporton thellësinë e skanimit të sondave deri në 40cm nuk mund të ekuivalentohet me thellësinë e skanimit të sondës kardiake të ofruar nga operatori ekonomik, për të cilën nuk kemi asnjë detaj të tillë.*

*Operatori Ekonomik ka synuar të sjellë në vëmendje të AK dhe KPP se katalogët janë dokumente standarte dhe nuk mund të përmbajnë dhe kritere teknike “periferike” të përshtatshme sipas kërkesave të AK. Sikundër, mund të konkludohet nga analiza e mësipërme, modalitetet e skanimit, formati i imazhit apo thellësia e skanimit të sondave nuk mund të cilësohen si kritere periferike. Këto kanë të bëjnë me funksionalitetin në themel të pajisjes dhe jo thjesht përshkrime “periferike”. Në rastin e integritetit të tyre në pajisje apo në rastin e përmirësimit të këtyre modaliteteve, kemi të bëjmë me një pajisje të re e cila ka nevojë gjithashtu për një vlerësim në themel nga Organet Ndërkombëtare për certifikimin CE. Siç oarashikohet në Dokumentat Standarte të Tenderit, certifikata CE është një dokument, mungesa e të cilit përbën shkak skualifikimi të operatorit ekonomik.*

*Lidhur me pretendimin se Operatori Ekonomik, në dokumentin “Deklaratë Mat” ka deklaruar se pajisja e ofruar prej ti plotëson të gjitha parametrat e parashikuar në DST, ky pretendim nuk qëndron pasi Operatori Ekonomik ka marrë përsipër të kryejë furnizimin apo lëvrimin e pajisjes sipa kërkesës së AK. Kjo kërkesë ka të bëjë me afatin brenda të cilit Autoriteti kontraktor ka kërkuar të pajiset me këtë artikull.*

*Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik ka arritur të plotësojë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentat e tenderit dhe kjo provohet përmes certifikatave dhe dokumentave të paraqitura me këtë deklaratë. Për sa më sipër, rezulton se deklarata e Operatorit Ekonomik dhe katalogu i markuar janë haptazi në kundërshtim me njëra-tjetrën, e*

*provueshme lehtësisht nga kriteri i formatit të imazhit, kriter minimal i cili parashikohet në çdo rast në mënyrë të detajuar nga çdo prodhues dhe nuk lihet në çmimin e blerësit apo distributorit për ta cilësuar përmes deklaratave.*

*Për sa argumentuam më sipër, pretendimi i OE nuk qëndron.”.*

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin 77, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer*

*shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre*

*vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 6/b, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti*

kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2.Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë,

*tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.1.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "BNT ELECTRONICS" SHPK ka të bëjë përkatësisht me pikën 2.3.4 "Kapaciteti Teknik", "Kriteret e veçanta të kualifikimit , referuar Shtojcës 7 sipas DST-se, në të cilin kërkohet: "Ofertuesi duhet të paraqesë katalog për mallin objekt prokurimi, me të dhënat teknike ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin objekt prokurimi". Operatori ka paraqitur katalogun me emërtim "Datasheet\_2\_Vinno.pdf.", për zërin me nr. rendor 1 referuar shtojcës 6 sipas DST, ku sipas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalog, janë evidentuar mospërputhje me ato të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Referuar këtij pretendimi rezulton e provuar se OE ankimues ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentin e titulluar "Datasheet\_2\_Vinno.pdf." nga ku mbas verifikimit Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara nga autoritetit kontraktor për zërin "ECHO KARDIAKE" dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik se bashkëlidhur ankesës ka dorëzuar dhe një deklaratë nga prodhuesi i pajisjes ku deklaroi se specifikimet teknike të cilat nuk janë përmendur në katalog plotësohen nga kjo pajisje nuk mund të merret në konsideratë nga ana e Komisionit, pasi kjo deklaratë mban datën 27.10.2023, përkthyer dhe noterizuar me nr. REP. 3921, datë 08.11.2023, që do të thotë është një dokument i marrë pas afatit të fundit të dorëzimit të ofertave e cila mban datën 23.10.2023.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "BNT ELECTRONICS" SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. *REF-83568-10-12-2023*, me objekt: “*Blerje ECHO KARDIAKE*”, me fond limit 2.500.2000 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**